

AKTI I THEMELIMIT
PËR SHOQËRINË "DAJLANI COMPANY" SHPK

Sot në Durrës në datën 07.01.2025 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "DAJLANI" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1. EMILIANO DAJLANI, shtetas shqiptar, i biri i Pëllumbit i datëlindjes 27-07-1989 lindur në Durrës dhe banues në Durrës, Lagjia nr. 3, Bulevardi "Epidamn", madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID I90727098B.
2. ENDRI DAJLANI, shtetas shqiptar, i biri i Pëllumbit i datëlindjes 18-06-1993 lindur në Durrës dhe banues në Durrës, Lagjia nr. 3, Bulevardi "Epidamn", madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID J30618074R.

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria tregtare "DAJLANI COMPANY" SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në DURRËS Lagjia 9, Rruga Aleksandër Goga, Pallati nr. 530, Kati i parë,. Me vendim të ortakëve të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria tregtare, do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100,000 lekë (Njëqind mijë lekë), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota, ku secila kategori është me vlerë nominale prej 50,000 lekë (Pesëdhjetë mijë lekë).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. EMILIANO DAJLANI, zotërues i 1 (një) kuote apo 50 % të kapitalit të shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.
2. ENDRI DAJLANI, zotërues i 1 (një) kuote apo 50 % të kapitalit të shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Agjensi komisionere për shërbime të shpejta postare, agjensi turistike, etj... të cilat nuk bien në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :
 - a- për ndryshime në statut
 - b- emërimin dhe shkarkimin e administratorit
 - c- miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.
 - d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
 - e- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë, është ENDRI DAJLANI me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barazvlefshme të tij.

Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKËT

EMILIANO DAJLANI

EMILIANO
DAJLANI


ENDRI DAJLANI

ENDRI
DAJLANI
